

VENDIM

Nr. 12, Datë 11.04.2012

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT SIPAS PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2012 – 2013 SI DHE KUOTAT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 11.04.2012, Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse,

VËREN SE

Tarifa e studimit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me propozimet e paraqitura nga IAL publike. Në këtë këndvështrim UART ka detyrimin që për programet e studimit që zhvillohen në këtë shkollë të paraqesë propozimet e veta lidhur me tarifën e shkollimit për programet e veçanta të studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, për çdo Fakultet.

Statuti i Universitetit të Arteve, përcakton në nenin 9, pika2, germa gj se tarifa e shkollimit miratohet paraprakisht nga Senati Akademik dhe më pas kalon në Këshillin e Administrimit. Pas miratimit edhe nga Këshilli i Administrimit, tarifat i propozohen Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore.

Fakultetet e UART kanë paraqitur zyrtarisht vlerën e tarifës vjetore të shkollimit për programet e studimit në secilin prej tyre. Senati i konsideron këto tarifa të përshtatshme dhe në përputhje me nevojat e shkollës, koston e studimeve si dhe interesin e studentëve.

Gjithashtu Fakultetet kanë propozuar edhe numrin e kuotave për programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, si kuotat për shqiptarët jashtë kufijve shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, Senati Akademik i Universitetit të Arteve

VENDOSI



1. Miratimin paraprak të tarifës vjetore të shkollimit për secilin program studimi në Universitetin e Arteve, sipas vlerave të përcaktuara në Lidhjen 1, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Këshillit të Administrimit të UART.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE



LIDHJA 1

Nr. rend	Fakulteti	Programi i studimit	Kuota	Tarifa vjetore e studimeve	Kuota shqiptarët nga trojet
Fakulteti i Muzikës					
1.		Kompozim	3	30.000	Maqedoni – 3
2.		Muzikologji	3	30.000	
3.		Dirizhim	3	30.000	Mali i Zi – 2
4.		Piano	8	30.000	
5.		Violinë	10	30.000	Kosovë – 5
6.		Violonçel	6	30.000	
7.		Violë	5	30.000	
8.		Kitarë	6	30.000	
9.		Kontrabas	4	30.000	
10.		Flaut	3	30.000	
11.		Oboe	3	30.000	
12.		Klarinetë	3	30.000	
13.		Fagot	3	30.000	
14.		Korno	3	30.000	
15.		Trombë	3	30.000	
16.		Trombon	3	30.000	
17.		Bastub	3	30.000	
18.		Këngëtar	10	30.000	
19.		Pedagogji Muzikore	9	30.000	
20.		Fizarmonikë klasike	4	30.000	
Gjithsej			95		10
Fakulteti i Artit Skenik					
1.		Akrim	10	30.660	Kosovë – 3
2.		Regji	8	30.660	Maqedoni – 2
3.		Skenografi dhe Kostumografi	10	30.660	Mali i Zi – 2 Preshevë
4.		Koreografi	12	30.660	Bujanovc - 1
5.		Regji filmi dhe TV	8	50.000	
Gjithsej			48		8
Fakulteti i Arteve të Bukura					
1.		Pikturë tekstili & modë	9	30.000	Grafikë – 2
2.		Pikturë kavaleti	8	30.000	
3.		Pikturë multimedia	10	30.000	Skulpturë - 1
4.		Pikturë monumentale	10	30.000	
5.		Pikturë grafike	14	30.000	
6.		Skulpturë	6	30.000	
7.		Skulpturë qeramike	6	30.000	
Gjithsej			63		3